



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Infinitt" Sh.P.K. të datës 25.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "169 Paisje, rekuizita sportive" me nr. të prokurimit 616-25-5614-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Infinitt" Sh.P.K. të datës 25.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "169 Paisje, rekuizita sportive" me nr. të prokurimit 616-25-5614-1-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 19.08.2025 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Infinitt" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 25.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "169 Paisje, rekuizita sportive" me nr. të prokurimit 616-25-5614-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. – “Grupi i OE ka dorëzuar ANEKS 6 Listen e kontratave të realizuara por nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dokumentare Referencat apo certifikatat për kryerjen e furnizimeve në vlerë jo më pak se 50,000.00”.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar listën e kontratave me vlerë të mjaftueshme të projekteve të realizuara mirëpo nuk ka dorëzuar referencat për të gjitha kontratat e prezantuara në këtë listë. Prandaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar ndërsa komisioni për rivlerësim duhet të kërkoj sqarime shtesë lidhur me referencat e munguara.

P.2. – “Grupi i OE poashtu kanë dorëzuar oferte jo-normalisht të ulët e cila është dashur të trajtohet nga AK konform nenit 61.1 të LPP-se dhe nenit 41.3 të RRPP”.

- Lidhur me këtë pretendim është gjetur se diferenca në mes të cmimit të ofruar nga parashtruesi dhe tenderuesi i rekomanduar është vetëm rreth 3-4 mijë euro. Ndërsa cmimi i ofruar nga tenderuesi i rekomanduar është shumë më pak sesa 30% e mesatares së ofertave të përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë komisioni për rivlerësim nëse e sheh të arsyeshme mund të kërkoj sqarime shtesë lidhur me cmimet e ofruara nga tenderuesi i rekomanduar duke përfshirë edhe pozicionet në paramasë nga nr. 13 deri te nr. 18. Prandaj edhe ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.08.2025


Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.